


SISTEMI MË I DREJTË



I QEVERISJES

DEMOKRACIA FLET

DIELLI (12), BLEONA (13), PJETËR (14), BEQIR (13), DIELLZA (12), URIMI (13), ALTINA (12)



Populli vendos në demokraci. Populli është i lirë dhe ka të drejta të shumta në këtë sistem të qeverisjes

Si do të ndiheshim ne po të mos ishin të drejtat e njeriut? Si do të ishte jeta jonë pa liri? A do të jetonim të lumtur nëse nuk do të kishim guximin ta shprehim mendimin tonë? Për t'i kuptuar këto, në vazhdim do ta tregojmë një ngjarje imagjinare.

Ishte kohë e lashtë, shumë njerëz nuk e kishin të drejtën të shprehnin mendimet e tyre dhe as nuk e pararendonin që ndonjëherë do ta kishin atë të drejtë. Qytetarët nuk e ngrinin zërin për të drejtat e tyre, sepse frikësoheshin që udhëheqësit e lartë do t'i ekzekutonin ose do t'iu merrnin edhe pronat dhe gjithçka që ata kishin. Mirëpo, për fat të mirë një person që ishte pak në moshë dhe që kishte përvojë për udhëheqje dhe për gjithçka që një popull e drejton drejt suksesit

dhe përparimit të tij dha një ide. Një ditë i mbledhi disa nga qytetarët dhe iu tha që së bashku ata mund të vepronin diçka, në mënyrë që secili të shprehte mendimet e veta lirshëm. Të gjithë e përkrahën mendimin e plakut dhe që nga ajo kohë të gjithë qytetarët e bashkuar treguan kërkesat e tyre, dhe kështu zëri i tyre filloi të dëgjohej. Të gjithë pastaj jetuan të lumtur. Me këtë ngjarje, grupi ynë dëshiron të tregoj rëndësinë që kanë të drejtat tona dhe se si jeta jonë ndryshon me këto të drejta dhe këto liri që i kemi. Të drejtat e njeriut dhe liria, janë elemente kryesore në demokraci, e cila është formë e qeverisjes ku populli udhëheq. Demokracia rrjedh nga fjalët greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. E ardhmja varet nga ne, sepse me punën tonë dhe me përkushtimin ndaj vendit ku jetojmë, do të kemi një ardhmëri të ndritur. Pra, le të punojmë zellshëm!



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona si qytetarë



Ne jemi populli

KUVENDI NË JETËN TONË

ANTONELLA (13), BLODI (12), YLLKA (13), ENRIK (12), SAIMIR (12), ARRITA (12), SHUKRIJE (14)



Të mësosh për Kuvendin është kënaqësi e madhe. Të kuptosh rëndësinë e këtij institucioni në jetën tëndë, gjithashtu është kënaqësi e madhe. Për më shumë, ne gazetarët e demokracisë, iu ftojmë të lexoni më poshtë artikullin tonë

Pas pak, më saktësisht, pasi ta shkruajmë këtë artikull, ne grupi ynë, së bashku me dy grupet e tjera do të shkojmë në Kuvend. Jemi shumë të lumtur që do të shkojmë pikërisht si gazetarë të këtij institucioni. Objekti i Kuvendit nuk është larg nga organizata TOKA, ku jemi ne. Në fakt, është shumë afër. Megjithatë, ne prapëseprapë do të respektojmë rregullat e komunikacionit. Ne do të kalojmë rrugën në vend kalimin për këmbësorë. Kjo neve na bën qytetarë të përgjegjshëm. Një gjest kaq i vogël, do të thotë shumë për ne si qytetarë. Kështu, do të jemi shembull edhe



për të tjerët. E ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe të gjitha ligjet e tjera, kanë dalur pikërisht nga Kuvendi. Kjo sepse, një ndër funksionet kryesore të Kuvendit është ai legjislativ, që nënkupton miratimin e ligjeve. Pra, 120 deputetët të cilët i zgjedhim ne qytetarët me votat tona, miratojnë ligje për ne. Ata gjithashtu na përfaqësojnë neve në Kuvend dhe ky funksion njihet si funksioni përfaqësues. Ndërkaq, Kuvendi po ashtu kontrollon punën e Qeverisë, andaj ka funksion kontrollues. Këto ishin tri funksionet kryesore të institucionit më demokratik, Kuvendit. Sot mësuam shumë për Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, mësuam se ligjet që miratohen nga deputetët, ndikojnë shumë në jetën tonë. Prandaj, deputetët dhe Kuvendi janë kaq të dashur dhe me shumë vlerë për ne.



Ne kështu bashkëpunojmë sepse e dijmë se me bashkëpunim vjen sukcesi




Sot në rolin e gazetarëve kuptuam shumë gjëra dhe morëm shumë informata. Këto informata i keni më lart në artikull



Të gjitha ligjet janë miratuar vetëm që ne si qytetarë të kemi jetë më të mirë. Prandaj, ne duhet t'i respektojmë të gjitha ligjet dhe kështu jeta jonë do të shëndrisë sikurse edhe yjet



Demokracia, ky emër kaq i dashur për ne dhe që na mundëson të kemi kaq shumë të drejta. Sof jemi shumë të lumtur që e kuptuam rëndësinë e saj



Ambienti ku jetojmë është përgjegjësi e të gjithë qytetarëve. A pajtoheni edhe ju se duhet ta ruajmë atë? Edhe nëse shohim mbeturina të vendosura në vendin që nuk iu takon, duhet të ndërmarrim diçka dhe ta pastrojmë atë ambient

RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE

XHONSON (13), RENIS (12), ARDIT (13), FATJONA (12), JULJETA (13), BLERTA (13), NATYRA (12)

Zgjedhjet janë proces pa të cilin demokracia nuk mund të funksionoj. Edhe për ne nxënësit, pa zgjedhje jeta jonë do të ishte më e zbehtë dhe jo shumëgjyreshe siç është sot

Të dashur dhe shumë të respektuar lexues, nga artikulli ynë, ju sot do të keni mundësinë të merrni shumë informata për zgjedhjet. Ajo çka do të keni mundësi po ashtu të mësoni është se pse titulli i artikullit tonë e thekson rëndësinë e zgjedhjeve.

Klasa jonë si çdo klasë tjetër ka nxënës shumë të mirë. Por, po ashtu kemi edhe nxënës që kanë prirje për të folur më shumë. Kjo është e drejtë e secilit, sepse ne jemi të lirë të jemi vetvetja.


Por, nganjëherë nxënësit të cilët më shumë preferojnë të flasin sesa të mësojnë, bien në kundërshtim me rregullat e klasës.

Rasti i i fundit ishte kur disa nga shokët tanë i thyen rregullat, të cilat ne vetë i kemi vendosur. Si p.sh. qetësia mbi të gjitha, stop ngacmimit ndaj njëri-tjetrit,

respekto që të të respektojnë, etj. Kujdestari i klasës vendosi që për këta nxënës që kanë vepruar kështu, të ketë dënime. Ai mendonte që nxënësit të cilët nuk i kishin respektuar rregullat e klasës të mos kenë mundësi të vijnë sot me ne në këtë Punëtori. Por, ishim ne ata të cilët votuam dhe vendosëm vetë se a e meritojnë të vijnë me ne edhe shokët e tjerë.

Ajo çka ne bëmë ishte votimi i lirë, ku të gjithë nxënësit, përveç atyre që ishin të dënuar votuam. Shumica prej nxënësve të klasës votuan që edhe shokët e tjerë të na bashkoheshin. Në këtë mënyrë edhe kujdestari i klasës u pajtua, dhe sot të gjithë jemi pjesëmarrës të kësaj Punëtorie.

Kjo erdhi si rezultat i zgjedhjes sonë dhe ne jemi shumë të lumtur me zgjedhjen që kemi bërë.



Këtu shokët e mi kanë dashur që përmes këtyre vizatimeve të tregojnë se edhe nxënësit apo fëmijët e moshave tona kanë të drejtë të bëjnë zgjedhje të lira. Zgjedhje bëhen në shtëpi, në shkollë, në parqet që ne luajmë, etj.

Nga shembulli paraprak deshtëm t'iu tregojmë se përmes zgjedhjeve mund të bëjmë ndryshim të madh. Ne, nuk kemi ende të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor, mirëpo shumë mirë e dijmë rëndësinë që ka një votë. Pasi që jemi tek sistemi, apo thënë më mirë procesi zgjedhor, nuk duhet të kalojmë pa cekur se kënd e votojnë qytetarët gjatë këtij procesi. Të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve. Në zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. E rëndësishme është se vota është e lirë dhe nuk imponohet. Këto që i thamë vlejné për Kosovën dhe për disa shtete të tjera demokratike, që funksionojnë si Kosova.



E drejta për të zgjedhur atë që më së shumti e duam



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë